



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 11612

Datë: 10/8/2020

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në mbledhjen e mbajtur më 30.07.2020, mori:

V E N D I M

- I. Partnerëve zhvillimor të UP-së dhe dy përfaqësuesve nga shoqëria civile- Koalicioni për Integritet dhe Transparencë në Universitet – KITU, dhe Platfoma CiviKos, u lejohet monitorimi i procesit intervistues dhe përzgjedhës të kandidatëve për rektor të UP-së.
- II. Mediave e shkruara (elektronike) dhe vizuale do tu lejohet vetëm marrja e pamjeve vizuale para fillimit të procesit të intervistimit të kandidatëve për rektor.
- III. Monitorimi do të lejohet me qëllim që procesi të jetë transparent për të gjitha palët e interesit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.


A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i UP-së, me qëllim të transparencës së plotë rreth procesit të intervistimit dhe të zgjedhjes së rektorit të UP-së, vendosi që procesi intervistues i kandidatëve dhe zgjedhja e kandidatit meritor për pozitën e rektorit të monitorohet nga mediat e shkruara (elektronike) dhe vizuale, partnerët zhvillimor të UP-së, dhe dy përfaqësues nga shoqëria civile: Koalicioni për Integritet dhe Transparencë në Universitet – KITU, dhe Platforma CiviKos.

Këshilli Drejtues konsideroi të arsyeshme që mediat e shkruara (elektronike) dhe vizuale të jenë të pranishme vetëm në hapje të mbledhjes, me ç' rast do të kenë mundësinë që të marrin disa pamje nga takim dhe pastaj ta lirojnë sallën e takimit. Partnerët zhvillimor të UP-së, dhe dy përfaqësuesit e shoqërisë civile KITU dhe CiviKos do të jenë të pranishëm gjatë gjithë procesit, respektivisht gjatë procesit intervistues dhe përzgjedhës të kandidatëve për rektor të UP-së. Arsyeja se përse KD-ja ka përzgjedhur dy organizatat e shoqërisë civile KITU dhe CiviKos është se këto dy organizata e monitorojnë procesin e arsimit në Kosovë. Mbi bazën e asaj që u tha më lartë, KD-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Anëtarëve të KD-së;
3. Zyrës Ligjore të UP-së;
4. Për publikim në ueb faqe të UP-së.



Këshilli Drejtues i UP-së

Dj. sc. Ujkan Bajra - kryesues.